

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i përgjithshëm**, gjyqtari, Kujtim Krasniqi, në çështjen penale të pandehurës: B.B. nga G.1, për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 325 par.2 të KPRK-së, e akuzuara sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.4229/15 të datës 22.03.2016, jashtëseancës, me datë 23.10.2017, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr. 4229/15 të datës 22.03.2016 për shqiptimin e urdhërit ndëshkimor,

Andaj gjykata konform nenit 495 të KPPK-së, jep:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

**E akuzuara;**

B.B., i ati I., i lindur më dt:..., në N., me vendbanim në fshatin G.1 komuna e G.2, me nr.presonal ..., e martuar, ka të kryer shkollën fillore, e gjendjes së dobët ekonomike, shqipëtar, – shtetase e Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse,

Me datë 31.05.2015, rreth orës 15:30, në qendrën tregtare “I.” në F.K. e pandehura B.B. me qëllim të përvetsimit të sendeve të huaja që vetës apo personit tjetër t’i sjell dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme, kanë hyrë në market dhe ka marrë dy palë hellonka për femna; brushë per flokë; dy çokollada; shampon për bebe; Pantollona per femna; ku në dalje të marketit është aktivizuar alarmi i sigurisë dhe gjatë kontrollës nga sigurimi janë gjetur sendet, ku dëmtuarës ndërmarrjes “I.”, i ka shkakuar dëm material në vlerë prej 32.85 euro,-

**-me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 325 par.2 të KPRK-së.**

Andaj gjykata konform neneve 4, 41, 43, 46, 73 të KPK, si dhe neneve 365 e 495, të KPPK-së i shqipton

**DËNIMIN ME GJOBË**

Në shumë prej **200(dyqind) Euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Dënimin e shqiptuar i pandehuri mund ta paguaj deri në dy (2) këste mujore në afat kohor prej 2 muaj por jo me gjatë se 2 (dy) vite nga dita e marrjes së formës së prerë e këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj.

Po që se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 46 të KPK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

**Obligohet:** i akuzuari që të në emër të shpenzimeve të procedurës penale, dhe atë në emër të paushallit gjyqësor, gjykatës t'ia kompenzojnë shumën prej **30** euro, të gjitha këtonë afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

**E dëmtuara:** Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit I. sh.p.k, F.K., lidhur me realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohen në kontest të rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr. 4229/15 të datës 22.03.2016, kundër të akuzuarës B.B. nga G., për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 325 par.2 të KPRK-së.

Gjykatës i është propozuar që kundër të akuzuarit të lëshoj Urdhrin Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtet e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 të KPPK-së Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe mori vendim që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: kallëzimi penal, procesverbali i vendit të ngjarjes, fotodokumentacioni i vendit të ngjarjes, janë prova të mjaftushme me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Andaj Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarës ekzistojnë elementet e veprës penale Vjedhja nga neni 325 par.2 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së, palët e dëmtuarajanë udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti i përgjithshëm-Penal**  
**P.nr.1595/16, të dt. 23.10.2017**

**Gjyqtari,**  
Kujtim Krasniqi

#### **KËSHILLA JURIDIKE;**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga marrja e të njëjtit, kësaj Gjykate, pas kalimit të afatit për kundërshtimurdhri ndëshkimor, merr formën e prerë.